32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranim të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimi përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimi do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Neni 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimi nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimi dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimi. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 624-25-4443-5-2-1/C1288

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Ndertimi i Kullës së Dëshmorëve në Budakovë me numër identifikues: 624-25-4443-5-2-1 & 624-25-02-521
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 15,830.50 euro 10% e vlerës së kontratës për një periudhë prej 120 ditësh
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhjeve është i pakufizuar

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 90 ditë kalendarike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit në baza ditore! Libri ndërtimor dhe Ditari ndërtimor do të mbahen në vend ndërtim gjatë tërë kohës së ekzekutimit të punimeve nga fillimi deri në përfundimin e punimeve
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim të ZKA-se
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% e vlerës së kontratës. Kjo shumë do të ndalet nga çdo pagesë (situation i punëve) e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë” të OE-së. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve (shëno nr. e viteve të periudhës garantuese)
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 15 ditë kalendarike pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e

		dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

Për:	ZYREN E PROKURIMIT KOMUNA SUHAREKË
Nga:	NN „XH. Kololli ", BUDAKOVË, BUDAKOVË
Lënda:	DEKLERATË PER KUALITETIN E PUNIMEVE
Datë:	01.07.2025

I/e nderuar,

Ndertimi i Kullës së Dëshmorëve në Budakovë me numër identifikues: 624-25-4443-5-2-1& 624-25-02-521

Për të përmbushur obligimet që dalin nga neni 27 pika 1 dhe 34.5 (KVK) e kontratës së lartcekur.


Ne konfirmojmë se:

Ne si Operator Ekonomik pas pranimit përfundimtar të kryerjes së punëve ofrojmë garancion të rregullt 1 vjeçar, duke siguruar garancion prej 10 % nga vlera e kontratës, si dhe deklarojmë mbi cilësinë e punës dhe mallrave në kohëzgjatje 1 vjet nga dita e pranimit përfundimtar të kryerjes së punimeve dhe obligohemi dhe pranojmë se defektet e paraqitura gjatë afatit garantues do t'i sanojmë në kohën sa më të shkurtër dhe pa asnjë kompensim. Në të kundërtën ne pajtohemi se AK ato dëme do t'i sanojë me tjetër OE dhe të njëjtat shpenzime do të na faturojë ne si Kontraktor që kemi dhënë këtë deklaratë mbi garantimin e punëve.

Me respekt:

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit : Xhem Kololli Nënshkrimi

Datë: 01.07.2025



Komuna e Suharekës
PARAMASA DHE PARALLOGARIA PER KULEN NE TSHATIN BUDAKOVE

VEREJTJE: Pjese perberese e paramases eshte PERSHKRIMI TEKNIK I PUNIMEVE, PROJEKTI, DETALET, SKEMAT GRAFIKE DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TE MATERIALEVE. Çmimi per çdo pozicion duhet te perfshije: Blerjen, furnizimin, transportin, punimin, montimin, lidhjet, sjelljen e pozicionit, ne glendje plotesisht funksionale, garancionin, kompletimin e certifikatave dhe atesteve te prodhuesve si dhe pergatitjen e vizatimeve detale per ekzekutimin e pozicioneve me kerkese te organit mbikqyres ('Shop Drawings') dhe metodën e ekzekutimit te pozicionit perkates, sipas pershkrimit teknik dhe specifikit te materialeve. Ne çmim duhet te kalkulohet gjithashtu i tere materiali shperzues deri ne leshuarjen ne funksion. Perzgjedhja e tekstures, ngjyres dhe elementeve tjera vizuale ne materialet per ekzekutimin e punimeve finale duhet te behet nga investitor/ organi mbikqyres. Llogaria e sasive te sakta te ekzekutuara per pagese, do te behet me liber ndertimor, pas perfundimit te tere sishesh me pozicioneve.

Te dhenat teknike dimensionet, sasive, etj. permes kesaj kontrate duhet te jene me SI – Sistem nderkombetar te njësive (International System of Units). Dimensionet per realizimin e pozicioneve gjithmone te merren dhe vertetohen ne vend, para fillimit te realizimit te pozicionit. Te gjitha Produktet e propozuara duhet te percillen me Certifikate kualiteti te prodhuesit duke i permbushur ISO standardet

1	Punët e Arkitekturës				
1.1	Punët përgatitore dhe shërbimet	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
1.1.1	Organizimi i punishtes: Organizimi i punishtes, nënkupton të gjitha aktivitetet dhe veprimet të cilat duhet t'i ndërmarrë punkyesi që punët e kontraktuara të realizohen në pajtim me Ligjet, rregullat në fuqi dhe kushtet teknike (Ligji i Ndërtimit, Kodet Unik i Republikës së Kosovës dhe Standardet e Ndërtimit të Kosovës) si sigurimi i punishtës, rrethimi, shenjëzimi i dukshëm me shenja treguese për rrethimet që mund t'u kanosen kalimtarëve, vendosjen e tabelës informuese, ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje, s, njëherit nënkupton edhe sigurimin e hapësirave adekuata përçollëse si dhe largimin e tyre pas përfundimit të ndërtimit. Sjellja e materialit dhe rrethimi i punishtes, me gardh jo transparent me lartësi dhe te dhëna sipas specifikit dhe pershkrimit teknik. Dizajni dhe konstruktimi i tabelës informuese me dimensione 1.5m x1.0m dhe emër të projektit, investitorit, kompanisë projektuese dhe kontraktorit. Tabela të konstruktohet sipas detajit. Sigurimi dhe vendosja e kontenerëve në punishte gjatë gjithë kohës për nevoja të punekryesit, puntoreve, organit mbikqyres, per materialet, tepricat dhe mbeturinat të cilat duhet të largohen dhe të dërgohen në deponinë e autorizuar (sipas pershkrimit teknik). Qasja ne Shërbimet komunale (ujesjelles, kanalizim, mbeturina), dhe në shërbimet e KEDS-it gjate kohezgjatjes se punimeve.	komplet	1.00	950.00 €	€ 950.00
1.1.2	Punimi i vizatimeve per ekzekutim (shop-drawings) dhe dokumentacionit Teknik- projekt sipas realizimit ("As-Built")	komplet	1.00	650.00 €	€ 650.00
				Total 1.1	€ 1,600.00
1.2	Punët e dheut dhe zhavorit	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
1.2.1	Gërmimi i gjere për të mundësuar hapsirën e themelëve të objektivit me dimensione sipas Projektit kryesorë dhe per nivelizimin e terenit. Kategorja e tokes IV-V). Në llogari të përfshihet edhe transportimi i materialit të tepërt deri në deponinë e Autorizuar. Nivelizimi i sipërfaqes se gërmuar dhe ngjeshja e saj. Llogaria ne m³ te sasise se materialit te gërmuar.	m³	95.00	3.00 €	€ 285.00
1.2.2	Furnizimi, shtrirja, Mbushja dhe Ngjeshja e Materialit zhavorik nën Themelë dhe nën pllake ne shtrese t-20m nga zhavori (gur i thyer) 0/63mm, ngjeshja e tij deri te arrihet moduli i ngjeshjes Mv = 50MPa. Materiali mbushës të prezantohet inxhinierit Mbikqyres për aprovim paraprak. Llogaria ne m³ te mbushjes se vendosur.	m³	26.00	18.00 €	€ 468.00





1.2.3	Furnizimi, shtrirja, Mbushja dhe Ngjeshja e Materialit zhavorik nën Themelë të mureve mbrojtëse në shtresë t=20cm nga zhavorik (gur i thyer) Ø/63mm, ngjeshja e tij deri të arrihet moduli i ngjeshjes $M_v = 40 \text{ MPa}$. Materiali mbushës të prezantohet Inxhinierit Mbikqyrës për aprovim paraprak. Llogaria në m ³ të mbushjes së vendosur.	m ³	5.00	18.00 €	€	90.00	✓
1.2.4	Furnizimi, Shtrirja e Zhavorit granular në fraksion 20/40mm në perimetrimin e Drenazimit përreth objektit. Materiali zhavorik të prezantohet Inxhinierit Mbikqyrës për aprovim paraprak. Llogaria në m ³ të zhavorit të vendosur.	m ³	17.50	22.00 €	€	385.00	✓
1.2.5	Furnizimi, Vendosija e GEOTEXTIL-it 300gr/m2 në pozicione sipas projektit.	m ²	72.00	1.50 €	€	108.00	✓
				Total 1.2	€	1,336.00	✓

1.3	Punët e betonit	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
1.3.1	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi i shtresës mbrojtëse me beton të lehtë I me trashësi t=6cm, mbi zhavorin e ngjeshur nën nivelin e themeleve dhe pllakes, me beton të klasit C-16/20, sipas projektit.	m³	8.00	50.00 €	€ 400.00
1.3.2	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi, sipas projektit, i themelit pllake të objektit dhe strukturave tjera në nivel të themeleve me beton të klasit C 30/37. Në llogari të përfshihet sigurimi, transporti, pahite, inkorporimi i the të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij pozicioni.	m³	37.00	105.00 €	€ 3,885.00
1.3.3	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi, sipas projektit, i mureve dhe shtyllave të betonit me beton të klasit C 30/37. Në llogari të përfshihet sigurimi, transporti, pahite, dhe të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij pozicioni.	m³	12.00	110.00 €	€ 1,320.00
1.3.4	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi, sipas projektit, i pllakave të meskateve, pllakes së kulmit trajeve të betonit dhe shkalleve të jashtme me beton të klasit C 30/37. Në llogari të përfshihet sigurimi, transporti, pahite, inkorporimi i the të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij pozicioni.	m³	54.00	110.00 €	€ 5,940.00
1.3.5	Furnizimi me material, transporti dhe betonimi, sipas projektit, i mureve mbrojtëse, shkalleve dhe të gjitha strukturave tjera nga beton në parter me beton të klasit C 30/37 sipas detaleve në projektin e statikës. Në llogari të përfshihet sigurimi, transporti, pahite, inkorporimi i the të gjitha mjetet e nevojshme për kryerjen e këtij pozicioni.	m³	15.00	115.00 €	€ 1,725.00
				Total 1.3	€ 13,270.00

1.4	Punët e armimit	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
1.4.1	Furnizimi, transporti, prerja, lakimi dhe vendosja e armaturës së klasit B500B, neper të gjitha pozicionet ne objekt, sipas detajeve te armimit nga llogaria statike. Të gjitha punët duhet të kryhen ne pajtim me projektantin dhe në udhëzim të organit mbikëqyrës,	kg	12,980.00	1.05 €	€ 13,629.00
				Total 1.4	€ 13,629.00

1.5	Punët e muratimit	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
1.5.1	Furnizimi me material dhe muratimi i mureve perimetrike dhe mureve të brendshme me blloqe të argjilës G5, t=12, 20, 25cm. Në çmim të përfshihen të gjitha punimet dhe materialet e nevojshme për ndërtimin e mureve. Llogaria për m² të murit të punuar.	m²	72.00	105.00 €	€ 7,560.00




1.5.2	Furnizimi me material dhe punimi i oxhakut kryesor në kullë me dim. 120x70. Oxhaku duhet të jetë i punuar me tullë zjarreduruese nga brenda kurse nga jashtë i veshur me gur dekorativ travertin ose të ngjashëm dhe të ketë të gjitha figurat kombëtare si në foto (Shikojnë dhe Stemen e UÇK-së). Në çmim të përfshihet të gjitha materialet dhe punët për kompletimin e oxhakut të brendshëm sipas detajeve dhe përshkrimit teknik në lartësi 3.2 m.	cope	1.00	2,300.00 €	€ 2,300.00	✓
						
1.5.3	Furnizimi me material dhe punimi i oxhakut mbi pllaken e kulmit me dimensione të brendshme 30x40cm. Oxhaku nga brenda duhet të jetë i punuar me tullë zjarreduruese, i veshur me izolim termik lesh guri t-8cm 100 kg/m3 dhe i përpunuar me shtresë të ngjitesit dhe shtresë finale dekorative sipas sistemi ETICS. Në çmim të përfshihet të gjitha punimet për kompletimin e oxhakut, përfshirë mbulimin e oxhakut, Llogarit për m² të oxhakut të punuar.	m²	4.00	98.00 €	€ 392.00	✓
1.5.4	Furnizimi dhe montimi i oxhakut të ngrohjes qendrore me diametër të brendshëm të tubave Ø-300mm, përfshirë litarin, blloqet e betonit 4x40cm, kapakët dhe të gjitha pjesët tjera të nevojshme për kompletimin e oxhakut. Në pjesën mbi kulm oxhaku duhet të jetë i suvatuar dhe ngjyrosur. Në çmim të përfshihet edhe koka e oxhakut.	m²	11.00	70.00 €	€ 770.00	✓
				Total 1.5	€ 11,022.00	✓

1.6	Punët e trajtimit të mureve të brendshme dhe pllafoneve	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma	
1.6.1	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe punimi i suvasë me llaç të vëzhduar t=15-20 mm për mure dhe pllafone në perdhese. Në kalkullim duhet të përfshihet profilit këndore L në pjesët ku takohen muret me materiale të ndryshme si dhe shtresë finale suva rrafshuese t=3mm e cila nuk duhet të jetë e lempër por të jetë imitimi i suvatimit të vjetër, sipas Manualëve të Prodhuesit, Specifikimit Teknik dhe Projektit Kryesor.	m²	600.00	10.00 €	€ 6,000.00	✓
1.6.2	Furnizimi me material dhe suvatimi i mureve të brendshme dhe pllafoneve në tualeteve dhe hapësirë me lageshti me llaç çimentoje me trashësi min. 15mm.	m²	60.00	10.00 €	€ 600.00	✓
1.6.3	Furnizimi me material dhe ngjyrosja e mureve të brendshme përfshirë shtresën bazë dhe dy shtresa ngjyre finale. Nuancat i përcakton organi mbikqyrës në konsultim me investitorin.	m²	620.00	1.50 €	€ 930.00	✓
1.6.4	Furnizimi me material dhe veshja e mureve të brendshme me gur të përpunuar dekorativ me trashësi t-5cm sipas specifikimit teknik dhe detajeve në projekt. Në çmim të përfshihet të gjitha detalet e nevojshme dekorative për finalizimin e veshjes së murit përfshirë ngjitesin, fugat etj. Llogarit në m² të sipërfaqes së punuar me gur.	m²	30.00	45.00 €	€ 1,350.00	✓
1.6.5	Mveshja e kornizës së brendshme përreth dritareve me dërrasa dekorative t-3cm sipas detajit. Gjerësia e zhvilluar e veshjes max. 50 cm. Ngjyra duhet të jetë e ngjashme me ngjyrën e dritareve apo sipas udhëzimeve të organit mbikqyrës. Llogarit per m² të perimetrit të veshur të dritares.	m²	60.00	16.00 €	€ 960.00	✓
				Total 1.6	€ 9,840.00	✓
1.7	Punët e kulmit	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma	




1.7.1	Furnizimi i materialit dhe punimi i komplet konstruksionit të kulmit me dru sipas projektit dhe pershkrimit teknik. Ky pozicion përfshirë komplet konstruksionin mbajtës të kulmit, shtrojat, shtangimet e nevojshme sipas projektit, mahite dhe të gjitha elementet tjera sipas rregullave teknike. Druri duhet të jetë i tharë me lageshti max. 8%. Llogaria në m2 të sipërfaqes horizontale të kulmit.	m ²	125.00	22.00 €	€ 2,750.00	✓
1.7.2	Furnizimi i materialit dhe punimi i komplet konstruksionit të kulmit me dru sipas projektit dhe pershkrimit teknik për mbulesën e shkallëve të jashtme. Druri duhet të jetë i tharë me lageshti max. 8%. Druri duhet të përpunohet dhe trajtohet me preparate për të rezistuar kushteve klimatike. Ngjyra e drurit sipas projektit apo sipas kërkesës së organit mbikqyrës dhe përfutjesit. Llogaria në m2 të sipërfaqes horizontale të kulmit.	m ²	2.00	420.00 €	€ 840.00	✓
1.7.3	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm për mbulimin e kulmit të pjerret me dërrasa t=18 mm, përfshirë: Ilstellet 50/50 (çdo 35cm) dhe kontralistellave 30/50 (çdo 70cm) sipas Specifikimeve Teknike dhe Projektit Kryesor. Llogari në m2 të sipërfaqes mbuluese.	m ²	180.00	11.00 €	€ 1,980.00	✓
1.7.4	Ngjyrosja e dërrasave dhe konstruksionit të drurit të mbulesës së shkallëve me ngjyrë sipas udhëzimeve të organit mbikqyrës.	komplet	1.00	250.00 €	€ 250.00	✓
1.7.5	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe vendosja e membranës së pershkueshme nga avulli dhe rezistente ndaj ujit, me trashësi me peshe 100g/m ² , e vendosur mbi dërrasat të kulmit të pjerret, sipas specifikimit teknik dhe udhëzimeve të prodhuesit. Llogari në m2 të sipërfaqes mbuluese.	m ²	160.00	1.50 €	€ 240.00	✓
1.7.6	Furnizimi me material dhe vendosja e tregullave të argjilës në kulm (tërësi i tregullave të vjetra). Ngjyren e përcakton organi mbikqyrës në bashkëpunim me investitorin dhe përfutjesin. Në çmim të përfshihen kulmaret nga material i njëjti, lugjet dhe këndoret nga llamarinat e plastifikuar t=0.7mm, llamarinat e oxhaqeve dhe të gjitha elementet tjera të nevojshme për kompletimin e mbulesës në mënyrë që ajo të jetë funksionale. Llogaria në m2 të sipërfaqes së mbuluar të kulmit.	m ²	180.00	26.00 €	€ 4,680.00	✓
1.7.7	Furnizimi me material dhe punimi i shtresave mbi pllaken e kulmit : - membranë eundër avullit; - termoizollim EPS, t=15cm, ≥18kg/m ³ ; - estrich t=60mm	m ²	100.00	16.00 €	€ 1,600.00	✓
1.7.8	Të bëhet furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe instalimi i Ulluqeve Horizontale DN 160mm nga llamarinat e galvanizuar e ngjyrosur t=0.60 mm. Në llogaritje të përfshihen të gjithë elementet e lidhjes, nyjet, mbajtëset, aritrau, vida etj, sipas Manualit të Prodhuësit, Specifikimit Teknik dhe Projektit Kryesor. Ngjyren e përcakton organi mbikqyrës në bashkëpunim me përfutjesin.	m ²	50.00	10.00 €	€ 500.00	✓
1.7.9	Të bëhet furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe instalimi i Ulluqeve Vertikale DN 125mm nga llamarinat e galvanizuar e ngjyrosur t=0.60 mm. Në llogaritje të përfshihen të gjithë elementet e lidhjes, nyjet, mbajtëset, aritrau, vida etj, sipas Manualit të Prodhuësit, Specifikimit Teknik dhe Projektit Kryesor. Ngjyren e përcakton organi mbikqyrës në bashkëpunim me përfutjesin.	m ²	40.00	10.00 €	€ 400.00	✓
				Total 1.7	€ 13,240.00	✓

1.8	Punat e zhdruktimit	Njësia	Sasia sipas projektit	Cmimi njësi	Shuma	
1.8.1	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe montimi i dritareve me profile druri i bungut dhe me xham tre shtresorë 4 mm solar +14 mm argon + 4 mm float +14 mm argon + 4 mm Low E, Uw ≤ 1.3 W/m ² K. Në llogaritje përfshihen të gjitha elementet fiksuese, gomë termoplastike në perimetër të dritares sipas Manualëve të Prodhuësit, me hapje normale dhe kiper sipas Specifikimit Teknik, Projektit Kryesor dhe Skemave të dritareve. Ngjyren e profilit e përcakton organi mbikqyrës në bashkëpunim me përfutjesin.					
1.8.1.1	80x120 (harkore)	copë	12.00	520.00 €	€ 6,240.00	✓
1.8.1.2	100x170	copë	9.00	780.00 €	€ 7,020.00	✓
1.8.1.3	40x60 (harkore)	copë	4.00	220.00 €	€ 880.00	✓
1.8.2	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe montimi i pikoreve të jashtme dhe të brendshme të dritareve nga guri natyral me trashësi t=30mm dhe gjerësi maksimale b=40 cm, sipas Specifikimit Teknik dhe Projektit Kryesor.	m ²	43.00	18.00 €	€ 774.00	✓



1.8.3	Furnizimi me të gjithë materialin e nevojshëm dhe montimi i dyerve me profile druri i bungut dhe me xham dy shtresorë 4 mm solar +16 mm argon + 4 mm Low E, Uw ≤ 1.4 W/m²K. Në llogaritje përfshihen të gjitha elementet fiksuere, gumicat në perimetër të derës, dorëzat, sipas Manualëve të Prodhuësit, Specifikimit Teknik, Projektit Kryesor dhe Skemave të dyerve.				€	
1.8.3.1	110x220 (harkore) dyer te hyrjes ne perdhesë	copë	2.00	1,100.00 €	€	2,200.00
1.8.3.2	110x220 dëre e hyrjes në kat në parë	copë	1.00	670.00 €	€	670.00
1.8.3.3	100x220 (dëre e brendshme)	copë	2.00	670.00 €	€	1,340.00
1.8.3.4	90x200 (dyer te brendshme)	copë	4.00	600.00 €	€	2,400.00
				Total 1.8	€	21,524.00

1.9	Punët e Fasades	Njësia	Sasia sipas projektit	Çmimi njësi	Shuma
	 				
1.9.1	Furnizimi me material dhe veshja e mureve të fasades me gur te përpunuar dekorativ te kualitetit te larte me trashesi t-10cm qe perforcohen ne muret kryesore sipas rregullave teknike. Në çmim te përfshihet punimi i harqeve te dritareve dhe dyerve me gur dekorativ sipas detaleve, dëljet e vogla horizontale në fasade me gur dekorativ sipas detaleve, vendosja e termozolimit lësh guri t-80mm, 60kg/m³ i cili kapet ne muret perimetrike me ngjites adekuat dhe tipila, vendosja e membranës per menagjllimin e avujve si dhe te gjitha detalet tjera te nevojshme per kompletimin e fasades. Llogaria ne m² te siperfaqes së fasades te punuar. <i>Sqarim: Modeli i fasades dhe kornizave perreth dyerve dhe dritoreve duhet te jete si ne foton e mesiperme. Përpunimi i gurit duhet te jete si ne foto, lloji i gurit dhe ngjyra aprovohet nga organi mbikqyres ne konsultim me projektantin.</i>	m²	137.00	€ 145.00	€ 19,865.00
